



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 15.5.2023

Nr: 74

Ora: 20:30

URDHËR

PËR

**MARRJEN E MASAVE ORGANIZATIVE PËR PROCESIN NUMËRIMIT TË VOTAVE PËR KËSHILLIN
E BASHKISË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "b", dhe 2, të nenit 116/1 e vijues të Kodit Zgjedhor, të nenit 26, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të vendimit nr. 23, datë 24.4.2023, "Për organizimin e punës në Vendin e Numërimit të Votave, radhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore",

URDHËROJ:

1. KZAZ-të të cilat ndërpresin procesin e numërimit të votave për këshillin e bashkisë, të marrin masa organizative për ta rifilluar atë jo më vonë se ora 7:00 e datës 16 Maj 2023 dhe ta përfundojnë atë, jo më vonë se ora 16:00 e po kësaj date.
2. Ngarkohen KZAZ-të dhe GNV-të për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 2023 Nr.
Ora: 12:00



"Për disiplinimin dhe vazhdimin në mënyrë të pandërprerë të procesit të numërimit të të gjitha kutive të votimit të pranuar të rregullta për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"